

LIGJ
Nr.8385, datë 30.7.1998

PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGIMI I DETYRIMEVE TATIMORE DHE DOGANORE TË PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të nenit 6 pika 6 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 "Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim t'i japë zgjidhje problemit të detyrimeve fiskale që kanë ndaj buxhetit të shtetit, qofshin këto të natyrës nacionale apo lokale, të gjitha subjektet e kontrollit dhe administrimit të shpallura si të tilla në bazë të paragrafit të parë të nenit 4 dhe të paragrafit të parë të nenit 5 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë"", të cilat më poshtë do të quhen subjekte kontrolli.

Neni 2

Të gjithë detyrimet me natyrë tatimore dhe doganore (fiskale) të prapambetura dhe të papaguara nga subjektet e kontrollit deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji parashkruhen dhe nuk kërkohen nga organet tatimore dhe doganore.

Neni 3

Detyrimet ndaj organeve tatimore dhe doganore (fiskale) që do të krijohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në likuidimin e subjekteve të kontrollit nuk do të shlyhen.

Nuk i nënshtrohen paragrafit të parë të këtij neni detyrimet që krijohen për TVSH, akcizë dhe taksë doganore, me përjashtim të këtyre lloj detyrimeve që krijohen për makineritë e pajisjet teknologjike dhe pjesët e ndërrimit të importuara.

Neni 4

Administratorët e caktuar në bazë të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë"" janë të vetmit persona që kryejnë veprime në emër të subjektit të kontrollit me organet tatimore e doganore në zbatim të këtij ligji.

Neni 5

Subjektet e kontrollit përjashtohen nga detyrimet për pagesat e shërbimeve të ndryshme administrative e gjyqësore dhe tarifat përkatëse që administratori është i detyruar të marrë për ushtrimin e veprimtarisë së tij nga organet e ndryshme shtetërore.

Nuk i nënshtrohet parashikimit të paragrafit të parë të këtij neni detyrimi që mund të lindë për sigurimin e pasurisë së subjektit të kontrollit.

Neni 6

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin e tij nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2183, datë 11.8,1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani